



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 56/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje të gjyqtarëve, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nenad Llazic anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Iniciativës politike “Iniciativa Kroate e Kosovës” (HSK), të përfaqësuar nga David Koljic, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.413/2013 datë 13.05.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 16.05.2013, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET ankesa e Iniciativës politike “Iniciativa Kroate e Kosovës” (HSK) e përfaqësuar nga David Koljic, **si e bazuar**.

II. ANULOHET vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 413/2013 datë 13.05.2013 dhe çështja kthehet në rishqyrtim.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 14.05.2013, nga Iniciativa politike “Iniciativa Kroate e Kosovës” (HSK), të përfaqësuar nga David Koljic, paraqitur kundër vendimit me nr. 413/2013, datë 13.05.2013, të KQZ-së, me të cilin i është refuzuar kërkesa për regjistrimin e subjektit politik.

Ankuesi në ankesën e tij thekson se KQZ-ja, pas shqyrtimit të kërkesës për regjistrimin e Iniciativës politike HSK-së, si parti politike, pa ndonjë arsye dhe kriter të bazuar ligjor, ka refuzuar regjistrimin e kësaj partie, ku sipas parashtruesit të ankesës në vendimin e KQZ-së, me të cilin është refuzuar regjistrimi i kësaj partie është bërë me arsyetimin se nuk është arritur të bëhet mbledhja e 2/3 të votave të nevojshme nga anëtarët e KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë i ka bashkangjitur ankesës vendimin e KQZ-së për refuzimin e regjistrimit të partisë politike “Hrvatska Stranka Kosova”-HSK, me nr. 413/2013, të datës 13.05.2013, dhe rekomandimin e ZRRPC-së, për KQZ-në.

Parashtruesi i ankesës kërkon që të anulohet vendimi i KQZ-së, me Nr. 413/2013, dhe të udhëzoj KQZ-në për regjistrimin e Iniciativës Kroate të Kosovës, pasi që nuk ekziston asnjë arsye për refuzim të regjistrimit të paraparë me nenin 5 të Rregullës Nr. 1/2008.

KQZ-ja, në përgjigje në ankesë sërish ka cekur se arsye për refuzimin e kërkesës se së subjektit të lartpërmendur për regjistrim si parti e re është ajo se me rastin e votimit lidhur me këtë kërkesë nuk është arritur të mbledhen 2/3 të votave të nevojshme për regjistrim siç parashihet në neni 63.4 të LZP-së.

Po ashtu edhe në arsyetimin e vendimit të KQZ-së, me nr. 413/2013 datë 13.05.2013, theksohet se: KQZ-ja nuk arriti të mbledh 2/3 e votave të nevojshme.

PZAP, pasi që analizoi pretendimet e ankuesit si dhe të gjitha shkresat e lëndës gjeti se **ankesa është e bazuar,**

Edhe pse nga rekomandimi i ZRPPC-së, i bërë për KQZ-në lidhur me plotësimin e kushteve për regjistrimin e një subjekti të ri politik del se: Iniciativa politike HSK, i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore siç përcaktohen në Rregullën Nr.1/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, KQZ-ja ka refuzuar regjistrimin e subjektit politik të lartpërmendur me arsyetim se nuk arriti të mbledhë 2/3 të votave të nevojshme në kuptim të nenit 63 të LZP-së, pa dhënë asnjë arsyetim të mëtejshëm për refuzim të kërkesës së lartpërmendur.

Në nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr. 1/2008, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mënyrë shprehimore janë paraparë arsyet për refuzimin e regjistrimit të një subjekti të ri politik, ndërsa në rastin konkret në vendimin e goditur nuk janë dhënë asnjë nga arsyet që i referohen kësaj dispozite, kështu që PZAP, gjen se tani për tani, vendimit të lartpërmendur për refuzimin e regjistrimit të këtij subjekti politik mungon baza respektivisht arsyeja juridike e paraparë në nenin 5 të rregullës së lartpërmendur.

Me rastin e rivendosjes përkritazi me kërkesën e subjektit të lartpërmendur për regjistrim KQZ-ja serish do të vlerësoi bazueshmërinë e saj, dhe nëse eventualisht gjen arsye për refuzim patjetër duhet të i referohet dispozitës së lartpërmendur të nenit 5 në të kundërtën do duhej të bëhej regjistrimi i këtij subjekti politik.

Andaj duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 56/2013 më datën 16.05.2013

